

- 1 Po. Jo. Nuk e di. Nuk e kuptoj.
- 2 Si ju quajnë? Mund ta shkruani emrin në anglisht?
- 3 Ju lutemi shkruajeni adresën tuaj.
- 4 Sa vjeç jeni?
- 5 Mund të na jepni emrin dhe numrin e telefonit ose adresën e dikujt për t'ju kontaktuar?
- 6 Ju do të ekzaminoheni së shpejti nga një <sup>1</sup>doktor. <sup>2</sup>infermiere.
- 7 Keni patur një aksident? Kur? (tregoni me gisht në kalendar dhe në orë)
- 8 E humbët ndërgjegjen?
- 9 Kur u sëmurët? (tregoni me gisht në kalendar dhe në orë)
- 10 Keni dhembje? Tregoni se ku. Kur filloi? (tregoni me gisht në kalendar dhe në orë)
- 11 Cili është niveli i dhimbjes që keni? 1 (nuk keni dhimbje) 2 3 4 5 6 7 8 9 10 (dhimbje kronike)
- 12 Dhimbja është e vazhdueshme? Apo vjen dhe ikën?
- 13 A keni gjakrrjedhje? Tregoni se ku.
- 14 A keni pasur kollë? A nxirrni diçka pas kollës?  
Çfarë ngjyre? e bardhë? e verdhë në të gjelbër? e kuqe? kafe?
- 15 A ju merret fryma?
- 16 Keni vjellë? Keni vjellë gjak?
- 17 Keni pasur diare?
- 18 Jeni kaps?
- 19 Keni bërë nevojë me ngjyrë të zezë?
- 20 Ju janë fryrë gjunjët?
- 21 Jeni dobësuar?
- 22 Keni vështirësi <sup>1</sup>shikimi? <sup>2</sup>dëgjimi? <sup>3</sup>gëlltitjeje? <sup>4</sup>të ecni?
- 23 Keni kaluar ndonjë operacion? Tregoni se ku.
- 24 Kur ju filloi cikli i fundit menstrual? (tregoni në kalendar)  
Jeni shtatzënë? Sa muajshe jeni?  
Ka mundësi të jeni shtatzënë? Mund t'ju bëjmë një test barre?
- 25 Pini cigare? Sa cigare në ditë?
- 26 Vuani nga <sup>1</sup>diabeti i fëmijëve? <sup>2</sup>epilepsia? <sup>3</sup>astma?
- 27 Keni pasur ndonjëherë <sup>1</sup>probleme me zemrën? <sup>2</sup>anginë? <sup>3</sup>tension të lartë të gjakut?  
<sup>4</sup>infarkt? <sup>5</sup>aksident çerebral? <sup>6</sup>(verdhëz)ikter? <sup>7</sup>hepatitë?
- 28 Jeni alergjik nga ndonjë ilaç? Penicilinë? Aspirinë? Ilaç tjetër?
- 29 Merrni ndonjë ilaç tani? Keni ndonjë me vete?  
A merrni mjekime të tjera ose mjekime natyrore?
- 30 Sa tableta keni marrë?
- 31 Jeni të mbuluar nga vaksina e tetanozit?

- 32 Keni qenë në tjetër vend jashtë Mbretërisë së Bashkuar kohët e fundit? Ku? Kur?
- 33 Unë jam një: <sup>1</sup>infermiere. <sup>2</sup>doktor. <sup>3</sup>dhënës i ndihmës së shpejtë. <sup>4</sup>paramjek. <sup>5</sup>punonjës social.
- 34 Mund t'ju ekzaminohet? E keni problem të ekzaminoheni nga një <sup>1</sup>burrë? <sup>2</sup>grua?
- 35 Më vjen keq, kjo mund t'ju dhembë.
- 36 Duhet t'ju mas tensionin e gjakut.
- 37 Duhet t'ju dëgjoj kraharorin.
- 38 Duhet t'ju testoj zemrën.
- 39 Duhet t'ju ekzaminohet për sëmundjet e brendshme.
- 40 Duhet t'ju bëj një injeksion.
- 41 Duhet t'ju fut këtë tub.
- 42 Duhet t'ju marr një analizë gjaku.
- 43 Duhet t'ju dërgoj për një radiografi.
- 44 Duhet t'ju vë disa penjë.  
Duhet të shkoni tek mjeku juaj që t'ua heqë ato në këtë ditë (tregoni me gisht në kalendar dhe në orë).
- 45 Keni thyer/frakturuar: <sup>1</sup>këmbën. <sup>2</sup>gjurin. <sup>3</sup>krahun. <sup>4</sup>kyçin e dorës. <sup>5</sup>shpatullën.
- 46 Duhet t'ju vemë në allçi: <sup>1</sup>këmbën. <sup>2</sup>gjurin. <sup>3</sup>krahun. <sup>4</sup>kyçin e dorës.
- 47 Duhet ta mbani këtë (tregoni) deri në këtë datë (tregoni në kalendar).
- 48 Ju lutemi hidhni ujë në këtë enë.
- 49 Mos hani as mos pini gjë.
- 50 Mund të ngriheni tani.
- 51 Duhet të rrini në spital.  
Ju lutemi prisni derisa të lirohet një krevat në pavion.
- 52 Çdo gjë do të shkojë mirë. Mos u merakosni.
- 53 Mund të thërres një taksì për ju?
- 54 Përdorni këtë nëse keni nevojë për ndihmë.
- 55 Ju lutemi prisni. Ejani këtej. Mund të shkoni në shtëpi.
- 56 Ju lutemi kthehuni, nëse keni probleme përsëri.
- 57 Më lejoni t'ua përsëris...

### Pyetje prej pacientëve

- 58 Sa do të pres? deri në 1 orë deri në 2 orë deri në 3 orë deri në 4 orë
- 59 A do ta thërresë njeri emrin tim?
- 60 Ku është telefoni, duhet të telefonoj familjen/një shok?
- 61 Mund të më thërrisni një taksì të shkoj në shtëpi?
- 62 A do të bëhem mirë?